

Televizioni Klan, 10 maj 2003

Interviste e Kryetarit te Prezences se OSBE-se ne Shqiperi, Ambasadorit Osmo Lipponen

Nga Ornela Bego

OSBE ka tashmë një rol të ri në Shqipëri dhe riorientimi i aktivitetit të saj ka qenë i sukseshëm dhe i dobishëm për vendin. Kështu është shprehur kreu i prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Osmo Lipponen, në një intervistë për televizionin Klan, duke kundërshtuar kështu zërat që kërkojnë largimin e këtij misioni nga Shqipëria. Ai ka shpjeguar ecurinë e bisedimeve për ndërmjetësinë më të fundit që OSBE ka marrë përsipër, gjetjen e konsensusit me të gjitha palët për ligjin e pronave. Ambasadori Lipponen tregon gjithashtu se OSBE ka përgatitur një tjetër raport për Shqipërinë, i cili do të bëhet publik në fillim të muajit qershor.

- **Megjithë perpjekjet e OSBE-se me komisionin parlamentar dypalesh, procesi ka ngecur tek ceshtja e anetarit te shtate te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve, gje ka bllokuar, gjithashtu, zevendesimin e anetareve qe u ka mbaruar mandati. Si mendoni ju se mund te zgjidhet ky problem dhe a do te nderhyje OSBE-ja perseri?**

Une jam i sigurte se problemet qe kane mbetur do te zgjidhen permes negociatave dhe jam, gjithashtu, i sigurte se ne do te kemi perseri nje rol ne lehtesimin e ketij procesi dhe gjetjen e zgjidhjeve te nevojshme. Ne po e ndjekim situaten nga afer dhe jemi ne mes te disa proceseve qe presim te zhvillohen me tej.

- **A do te perfshihet perseri OSBE-ja ketu?**

Ndoshta po, por mund te perfshihesh vetem nese te kerkohet kjo gje dhe duket se edhe qeveria edhe opozita jane shume te kenaqur me rolin tone dhe po na ftojne te japim ndihmesen perseri per t'i dhene forme perfundimtare ketyre detajeve te vogla qe kane mbetur te hapura.

- **OSBE-ja eshte angazhuar qe te negocioje per hartimin e nje ligji per pronat me konsensusin e te gjitha paleve. Si mendoni se mund te realizohet kjo? A i keni filluar negociatat?**

Shume pune, urtesi politike dhe vullnet per kompromis do te nevojiten per te perfunduar kete detyre. Ne kemi filluar tashme me pjesen praktike te punes dhe jemi ne fazen e mbledhjes se te dhenave te tjera, krijimit te ekipit tone te eksperteve dhe perfundimin e kontakteve me te gjitha palet dhe qeverine. Une kam diskutuar kohet e fundit ne nivelet

me te larta politike lidhur me harten e rruges dhe lidhur me ate se si do procedojme. Eshte praktikisht njesoj me ate per te cilen kemi rene tashme dakort me kryetarin e Parlamentit, me disa modifikime te vogla, te cilat na jane dukur te nevojshme, pasi kemi marre komentet e para nga palet. Tani kemi kohe te mjaftueshme per ta perfunduar punen nga fundi i korrikut. Aktualisht, jemi ende duke hedhur themelet, te cilat perfshijne bisedime te tjera me grupe te ndryshme. Parlamenti do te beje me vone punen e tij dhe ne do te shohim me pas rezultatet perfundimtare. Une mendoj se ne dhe, para se gjithash, Parlamenti do te gjejme zgjidhje politike te mira, afatgjata dhe te drejta.

- **A do te jete e veshtire kjo gje?**

Sigurisht qe do te jete e veshtire, por une kam besim se do t'ia dalim.

- **Raporti i fundit i OSBE-se ishte shume kritik ndaj zhvillimeve ne vend. A shihni you ndonje perparim? A do te dale OSBE-ja me ndonje raport tjetër per muajt e fundit?**

Une do te thoja se raporti ishte shume konstruktiv dhe i drejte. Ai u mireprit, gjithashtu, nga qeveria. Nje nga bindjet e mija eshte se duhet te flasesh per faktet me terma reale. Problemet me te cilat perballet Shqiperia jane shume te medha dhe duhet ta pranojme qe ato nuk mund te zgjidhen sa hap e mbyll syte. Ato duan pune te vazhdueshme dhe afatgjate. Raporti yne i ardhshem do te paraqitet para Keshillit te Perhershem te Vienes ne fillim te qershorit.

- **Cfare do te thuhet ne raport?**

Eshte pak shpejt te thuhet se cfare do te thuhet ne te. Ai do te permbaje disa elemente positive, por do te vazhdoje me nje qendrim konstruktiv, pozitiv por edhe kritik.

- **Cilat jane fushat per te cilat do te kete kritika?**

Une mendoj se te jesh kritik, ne fakt, nuk do te thote kritike. Kjo do te thote se ne do t'i pranojme veshtiresite qe ekzistojne. Gjithashtu, do te na duhet te themi hapur nese ka patur perparime, nese perparimet kane qene te ngadalta etj. Por do te kthehesha tek ajo qe kam thene. Problemet jane te medha dhe eshte normale qe te presim te kemi veshtiresi. Po flasim per nje proces afatgjate, i cili kurdohere ka nevojë per nje shtyese perpara.

- **Cili eshte opinionimi juaj lidhur me krimin e organizuar dhe trafikimin, si dhe luften kunder tyre?**

Krimi i organizuar, korrupsioni dhe trafikimi jane disa prej ceshtjeve te veshtira dhe te pafund qe vendi po perpiqet te zgjidhe. Ato jane aq te medha sa kerkojne perpjekje te metejshme te koordinuara te qeverise shqiptare dhe bashkesise nderkombetare. Kjo eshte e vetmja menyre per te arritur rezultate afatgjata.

- **Si do ta vleresonit klimen politike ne vend pas deshtimit te marreveshjes midis Nanos dhe Berishes? A mendoni se do te ndikonte disi ne fushaten per zgjedhje vendore?**

Duhet ta pranoj qe nuk jam dakort me ju. Edhe pse ka patur ulje dhe ngritje ne kete proces, une mendoj se kjo marreveshje eshte nje sukses i madh dhe arriti rezultatet kryesore qe deshironte. Ajo cka nuk eshte lavderuar sa duhet eshte qe se ajo solli, per here te pare ne nje kohe shume te gjate, negociata te verteta dhe elemente konsensuale ne politiken e ketij vendi, si dhe nje mirekuptim te nevojshem per te gjithë. Deri tani, e gjithë politika eshte etiketuar nga e ashtuquajtura te menduarit e “shumes zero”, gje qe eshte shume e demshme.

- **Cfare mendoni lidhur me pergatitjet per zgjedhjet vendore? Sipas OSBE-se, a eshte gati infrastruktura zgjedhore?**

Pergatitjet praktike kane filluar. Ato jane vetem ne fazen fillestare. Sic thuhet edhe ne media, hapat e pare per regjistrimin e votuesve jane hedhur. Ky eshte nje proces i gjate dhe i veshtire, per te cilin une besoj se bashkësia nderkombetare, dhe vecanerisht OSBE-ja dhe ODIHR-i, do te japin mbeshtetjen e tyre, ne menyre qe zgjedhjet te zhvillohen ne nje situate teknike perfekte.

- **A mendoni se prania e OSBE-se eshte ende e nevojshme ne Shqiperi?**

Une jam nje perkrahës i forte i ketij mendimi. Dhe, pa dyshim, nuk eshte vetem mendimi im qe ne kemi gjetur nje rol te ri; riorientimi i aktivitetëve tona ka qene shume i suksesshem dhe kemi qene te dobishem per kete vend. Dhe, nese i referohem opinionit te qeverise dhe politikaneve te ndryshem, te merkuren, kryeministri Nano me tha shume qarte se prania jone eshte shume e mirepritur ketu dhe se qeveria nuk po na tregon deren. Gjithashtu, kemi patur edhe mbeshtetje nga opozita. Keshtu qe mendoj se kjo eshte nje situate shume e mire dhe e shendetshme, ne te cilen ne mund te vazhdojme te punojme me mandatin tone dhe t’i sigurojme sherbime konstruktive Shqiperise.